



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Kryesia e Kuvendit  
P-027  
Prishtinë, më 8 korrik 2008, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE  
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 8 KORRIK 2008**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Nexhat Daci, Naim Maloku, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Xhezair Murati dhe Sllobodan Petroviq;

Nga grupet parlamentare: Safete Hadërgjonaj, Lutfi Haziri, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini dhe Zylfi Merxha, ndërsa munguan Ibrahim Makolli dhe Bojan Stojanovq.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skënder Reçica dhe Sherif Konjufca ;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu; dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai i propozoi edhe katër pika shtesë.

**Kryesia**, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

#### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtura më 2 korrik 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave, dhe
4. Të ndryshme.

#### **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 korrik 2008**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 2 korrik 2008, u miratuan pa vërejtje.

#### **2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare**

**Kryetari** i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës. Ai kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë të propozuar, veç e veç.

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e radhës të mbahet më **15 korrik 2008**, në orën 10:00, me këtë

#### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 30 qershor 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë private,
4. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shqyrtimit të Projektligjit për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shqyrtimit të Projektligjit për punë,
6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shpalljes të Ligjit për sigurimin shëndetësor,
7. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës.

### **3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave**

3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion lidhur me procedimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

**Kryesia**, pasi shqyrtoi Rekomandimin e këtij komisioni, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

Raporti me rekomandime lidhur me procedimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme i kthehet Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion për rishikim të rekomandimeve.

3.2 Shqyrtimi i mocioneve të deputetit Driton Tali për nxjerrjen e një deklaratë kundër formimit të strukturave paralele komunale në Kosovë dhe lidhur me letrën e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, z.Ban Ki Mun

**Kryesia**, pasi i shqyrtoi mocionet e deputetit Driton Tali, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

Mocionet e parashtruara nga deputeti Driton Tali për nxjerrjen e një deklaratë kundër formimit të strukturave paralele komunale në Kosovë dhe të asaj lidhur me letrën e Sekretarit të OKB-së, z.Ban Ki Mun, nuk i plotësojnë kushtet formale, ngase, në ndërkohë, një deputet – mbështetës i mocionit e kishte tërhequr, me shkrim, nënshkrimin e tij.

3.3 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian për fillimin e procedurës së anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e këtij komisioni, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

Nisma për fillimin e procedurës për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës shtyhet për më vonë, kur të krijohen rrethana më të përshtatshme për procedimin e saj.

3.4 Shqyrtimi i propozimit të deputetit Arsim Rexhepi për mundësinë e vendosjes së një kopjeje të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës në muralet e Kuvendit të Kosovës

Propozimi i deputetit Arsim Rexhepi për vendosjen e një kopjeje të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës në muralet e Kuvendit të Kosovës do të shqyrtohet në proces e sipër.

3.5 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Ad hoc për lejimin e kompensimit për punën në shqyrtimin e projektligjeve nga Pakoja e Ahtisarit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

## V E N D I M

1. Lejohet kompensimi i anëtarëve të Komisionit Ah - hoc dhe i stafit mbështetës për punën gjatë shqyrtimit të projektligjeve.
2. Pagesa për anëtarët e Komisionit Ad - hoc bëhet në shumën prej 50€ për mbledhje, kurse për stafin mbështetës të Administratës në shumën prej 30€ për mbledhje.

### 3.6 Shqyrtimi i kërkesave për kompensimin e mëditjeve të deputetëve gjatë udhëtimeve zyrtare jashtë vendit

Kryesia miratoi kërkesat për kompensimin e mëditjeve të kryetarit dhe të anëtares së Komisionit për Punë, Shëndetësi dhe Çështje Sociale, Sadik Idriz dhe Mimoza Ahmetaj, të cilët kishin marrë pjesë në një seminar në Sarajevë prej 29 qershor deri më 01 korrik 2008; të shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri, i cili kishte marrë pjesë në Seminarin e 69-të të Asamblesë Parlamentare të NATO-s “Rose-Roth, në Mal të Zi, prej 23 deri më 26 qershor 2008; dhe të shoferit të anëtarit të Kryesisë, Ibrahim Gashi, i cili kishte qëndruar një ditë më tepër në Mal të Zi se sa që i ishte lejuar me vendimin e mëhershëm.

### 3.7 Shqyrtimi i Propozim - vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për kompensimin e punës për angazhimet shtesë të deputetëve dhe të Administratës

Kryesia miratoi propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kompensimin e punës për angazhimet shtesë për deputetët dhe stafin e Administratës së Kuvendit, sipas propozimit të komisionit.

### 3.8 Shqyrtimi i Propozim –vendimit për përmbylljen e shpenzimeve të udhëtimeve zyrtare

Kryesia miratoi propozimin e sekretarit të Kuvendit për mbylljen e avancave, që ishin dhënë për udhëtimet zyrtare jashtë vendit.

## 4. Të ndryshme

- 4.1 Kryesia u njoftua me Raportin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për vizitën që kishte realizuar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, prej 16 deri më 19 qershor 2008.
- 4.2 Anëtari i Kryesisë, Xhezair Murati, ngriti çështjen e ndarjes së donacioneve për OJQ-të në komunën e Sharrit nga ana e Ministrisë për Kthim dhe Komunitete.

**Kryesuesi** e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

---

E hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**